



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

VENDIM
Nr. 13, datë 25.01 2021

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS TË Z. INDRIT SHTUPI NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020.

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

Artur Metani - Kryetar
Mirela Kapo - Anëtare
Marsela Pepi- Anëtare

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 13 . 01 .2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR JO MAGJISTRAT

Zoti INDRIT SHTUPI

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Z. Indrit Shtupi, në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jo magjistratë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe zoti Indrit SHTUPI.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

6. Zoti Indrit SHTUPI, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me kërkesën me nr.prot 409, në datën 28.02.2020 ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, nisur dhe nga detyrimet ligjore, kandidati, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur

pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 28.04.2020, kandidati Indrit SHTUPI, është paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 07.05.2020, kandidati Indrit SHTUPI ka depozituar në sekretarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me Vendimin nr. 99, datë 01.12.2020 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Indrit Shtupi për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati për Inspektor Jomagjistrat.

Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në datat 11.01.2021 dhe 12.01.2021, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për gjashtë vendet vakante. Intervista mbi motivimin e kandidimit, Z. Indrit Shtupi, kandidat për të gjashtë vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 11.01.2021.

II. Vlerësimi i Komitetit

10. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe me praninë e përfaqësueses së misionit “Euralius”, Znj. Anita Mihailova, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme,

Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Indrit Shtupi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Indrit Shtupi, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- 1) Ndihmës avokat pranë një zyre avokatie në shtetin Grek, 2001-2005;
- 2) Inspektor pune pranë Inspektoriatit shtetëror të punës në Ministrinë e ceshtjeve sociale dhe Shanseve te barabarta, 2006-2007;
- 3) Përgjegjës i sektorit të Auditimit të brendshëm të INUK, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, 2008-2010;
- 4) Inspektor Ndërtimor, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, 2010-2011;
- 5) Pedagog pranë Universitetit jopublik “Vitrina”, 2011-2012;
- 6) Pedagog pranë Universitetit jopublik “Wisdom University”, 2015-2016;
- 7) Përgjegjës i mbledhjes së borxhit, pranë spitalit jopublik “Hygea”, 2014-2018;
- 8) Konsulent ligjor, 2016-në momentin e aplikimit pranë I.L.D-së;

Historiku Arsimor

12. Në shkronjën “A-HISTORIKU ARSIMOR DHE PROFESIONAL” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, diplome e nivelit të dytë të “Master i Shkencave” me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

13. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.

14. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Indrit Shtupi :

- Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 1996-2000, duke u diplomuar “*Jurist*” dhe nota mesatare e studimeve është **6.7**¹;

- Ka ndjekur studimet doktorale, në Fakultetin e Drejtësisë pranë Univeritetit jo publik “Universitetit Europian”, në periudhën 2012-2015 dhe duke u diplomuar me gradën shkencore “Doktor”, me vlerësimin “mirë”, në profilin “E drejtë publike”;

15. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare **6.7**

16. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare **6.7** e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Indrit Shtupi** me **0 (zero) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

17. Në shkronjën “**A-HISTORIKU ARSIMOR DHE PROFESIONAL**” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi **pasja e titujve akademikë, gradave shkencore**, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trainimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

18. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trainimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

19. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Indrit Shtupi :

- Ka ndjekur studimet doktorale, në Fakultetin e Drejtësisë pranë Univeritetit jo publik “Universitetit Europian”, në periudhën 2012-2015 dhe duke u diplomuar me gradën shkencore “Doktor”, me vlerësimin “mirë”;

20. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Grada shkencore**”. **Në total**, për këtë kriter vlerësimi kandidati Indrit Shtupi vlerësohet me **2 (dy) Pikë**.

¹ Gjatë perlllogaritjes se mesatares nuk llogaritet provimi I shtetit.

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Indrit Shtupi ka ndjekur disa veprimtari trainimi afatshkurtra të dokumentuara , konkretisht:

Lista dhe lloji i trainimeve

22. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Indrit Shtupi, ka kryer këto trajnime:

1. Periudha 2015, Greqi

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Kushtetuta Europiane dhe mbijetesë e mjedisit*”.
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti i Mjedisit dhe mbijetesës;

2. Periudha 2005, Greqi

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Investime dhe zhvillime në Ballkan: Sfida të reja për ndërmarrjet Greke*”.
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti ndërkombëtar i marrëdhënieve ekonomike;

3. Periudha 2002, Greqi.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Programet kompjuterike Microsoft ëindoës*»
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: INFO In Zbatim Kompjuterik;

23. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trainuese të ndjekura nga kandidati **Indrit Shtupi**, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1 (një) pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

Gjuhët e huaja

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njih shumë mirë gjuhën Angleze dhe gjuhën greke.

Në dosje ndodhet një “Deklarim për zotërimin e gjuhëve të Huaja” sipas së cilës deklararon se zotëron “Certifikatë të gjuhës angleze dhe certifikatë të gjuhës greke”.

25. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Indrit Shtupi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **2 (dy) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

26. Në shkronjën “**B-KUALIFIKIMI I PËRGJITHSHËM PROFESIONAL**” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi, në lidhje me **kualifikimin e përgjithshëm profesional**,

përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i emerimit dhe vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhërit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

28. Në rastin e kandidatit Indrit Shtupi, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

29. Për sa i përket vlerësimit sasior, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati,

- Kërkimi shkencor me temë “*Legal responsibility in case of accidents in work and professional diseases according to albanian legislation*”, botuar në konferencën shkencore të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”, në vitin 2018, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*The albanian the laë on entrepreneurs and companies: An overview and its problems in the approximation process to EU*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”, në vitin 2017, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*The Western balkans and the european Union, Enlargment and challenges*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”, në vitin 2017, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Approaches and the new developments on security*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Europian të Shqipërisë”, në vitin 2016, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Traktati i Lisbonës dhe BE*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Wisdom të Shqipërisë”, në vitin 2016, si autor i parë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Aktualiteti Ekonomik në Shqipëri dhe Sfidat drejt integritimit në BE*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Wisdom të Shqipërisë”, në vitin 2016, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Disa aspekte penale dhe kriminalogjike të trafikimit të të miturve shqiptar drejt europës gjatë viteve të tranzicionit*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Wisdom të Shqipërisë”, në vitin 2016, si autor i tretë;

- Kërkimi shkencor me temë “*Shkaqet e trafikimit të të miturve në vendin tonë*” botuar në konferencën shkencore të Universitetit Wisdom të Shqipërisë”, në vitin 2016, si autor i dytë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Kosovo nationalism and the NATO involvement in managing a neë crisis*” botuar në konferencën shkencore International conference on human and social sciences ICHSS, në vitin 2013, si autor i parë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Albanians have always respected the rules*” botuar në konferencën shkencore International conference on human and social sciences ICHSS, në vitin 2013, si autor i parë;
- Kërkimi shkencor me temë “*Eavesdropping and the rule of law, constitutional and criminal aspect of this phenomenon*” botuar në konferencën shkencore International conference on human and social sciences ICHSS, në vitin 2013, si autor i parë;

Artikuj shkencor

- Titulli i kërkimit: “*Impact of the criminal procedure of continental law and anglo saxon law in determining the principal of penal proceedings in albania*”, pranë Revistës Europiane të së drejtës Publike, botuar më 2019, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*the brexit process and its consequences*”, pranë Revistës Europiane të së drejtës Publike, botuar më 2019, autor i parë;
- Titulli i kërkimit: “*Equity financin and emission of shares*”, pranë MSCR Academic Journal of Interdisciplinary Studies, botuar më 2017, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*An Overvieë of the vienna convention on the law of treaties and its principles*”, pranë MSCER Academic Journal of Interdisciplinary Studies, botuar më 2017, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*The right of private porperty as a faundamental precondition of the republic of Albania in the process of europian integration*”, pranë Revistës Europiane të së drejtës Publike, botuar më 2017, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*Legal definition of res judicata*”, pranë Revistës Europiane të së drejtës Publike, botuar më 2016, autor i parë;
- Titulli i kërkimit: “*Kuadri kushtetues dhe ligjor ne fuqi, në Republikën e Shqipërisë kundër diskriminimit*”, pranë Revistës shkencore Wisdom, botuar më 2016, autor i parë;
- Titulli i kërkimit: “*the regulation of cyber crime in albania in the frame work of harmonization of internal legilation with the europian legislation*”, pranë Accademic Journal Of Interdisciplinary Studies, botuar më 2016, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*General overvieë on law nr.133/2015 for the treatment of the property and the completion of the process of property compensation in Albania*”, pranë Accademic Journal Of Interdisciplinary Studies, botuar më 2016, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*Protocol nr. 14 innovations for the operation of the european court of human rights*”, pranë Accademic Journal Of Interdisciplinary Studies, botuar më 2016, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*the decision commentary of the european court of human rights case O Keffee vs Irland*”, pranë Mediterranean Journal of social sciences, botuar më 2016, autor i dytë;

- Titulli i kërkimit: “*Evolution of european company law*”, pranë Accademic Journal Studies, botuar më 2015, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*Mediation: Origins of Mediation and development of family mediation*”, pranë Accademic Journal, botuar më 2015, autor i dytë;
- Titulli i kërkimit: “*The democratic impact of european integration :Case study of albania*”, pranë Mediterranean journal of social sciences, botuar më 2013, autor i parë;
- Titulli i kërkimit: “*the role of monarchy in the state building process of albania*”, pranë Mediterranean journal of social sciences, botuar më 2013, autor i parë;
- Titulli i kërkimit: “*concept of international society on international society as a legal community of herman mosler and the agenda of democratization of Boutros Boutros ghali*”, pranë Accademic Journal, botuar më 2013, autor i parë;

Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati Indrit Shtupi ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Indrit Shtupi për këtë kriter ligjor vlerësimi me **5 (pesë) Pikë**.

30. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë angazhimin e kandidatit në veprimtari të ndryshme në fushën e së drejtës, ku spikat aktiviteti i kandidatit si pedagog dhe angazhimi si konsulent ligjor pranë “agjentëve të ndryshëm ekonomik që veprojnë në tregun kombëtar”.

31. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 07.12.2020, kandidati **Indrit Shtupi** ka njoftuar Komitetin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur **dokumentet profesionale** si më poshtë:

- Vendimin nr. 4845 nr.2505 Akti, datë 06.06.2016, me paditës Indrit Shtupi, gjithsej nëntë fletë;
- Kërkesë padi ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me objekt “Shfuqimizimin e aktit administrativ”, gjithsej pesë fletë;
- Dokument i llojit “Diskutime përfundimtare të palës paditëse në çështjen civile I.Shtupi kundër I.N.U.K”, gjithsej katër fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë për revokim të aktit administrativ drejtuar ILD”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “kërkesë bërë në emër të administratorit të shoqërisë Ad-Star”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “rregullim i ndërgjyqësisë”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej katër fletë;

- Dokument i llojit “Kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej dy fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kodi i Etikës”, gjithsej tetë fletë;
- Dokument i llojit “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin , ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shoqërinë Ad Star shpk”, gjithsej dhjetëfletë;
- Dokument i llojit “Marreveshje bashkëpunimi”, gjithsej gjashtë fletë;
- Dokument i llojit “Ankim i vecante”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”, gjithsej tre fletë;

32. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **INDRIT SHTUPI** dhe, në veçanti, lidhur me dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme **përmbajtjen e tyre**, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2)

33. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, intervistës së zhvilluar me kandidatin, veçanërisht prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit Jomagjistrat.

34. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **Indrit SHTUPI** ka paraqitur para Komitetin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur **dokumentet profesionale** si më poshtë:

- Vendimin nr. 4845 nr.2505 Akti, datë 06.06.2016, me paditës Indrit Shtupi, gjithsej nëntë fletë;
- Kërkesë padi ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me objekt “Shfuqimizimin e aktit administrativ”, gjithsej pesë fletë;
- Dokument i llojit “Diskutime përfundimtare të palës paditëse në çështjen civile I.Shtupi kundër I.N.U.K”, gjithsej katër fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë për revokim të aktit administrativ drejtuar ILD”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “kërkesë bërë në emër të administratorit të shoqërisë Ad-Star”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “rregullim i ndërgjyqësisë”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej katër fletë;

- Dokument i llojit “Kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit”, gjithsej një fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej dy fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë padi”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kodi i Etikës”, gjithsej tetë fletë;
- Dokument i llojit “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin , ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shoqërinë Ad Star shpk”, gjithsej dhjetëfletë;
- Dokument i llojit “Marreveshje bashkëpunimi”, gjithsej gjashtë fletë;
- Dokument i llojit “Ankim i vecante”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”, gjithsej tre fletë;

35. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **INDRIT SHTUPI** dhe, në veçanti, lidhur me dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).

36. Dokumentat trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport me të drejtat dhe detyrimet përkundrejt administratës publike pa përjashtuar këtu fushën e ekspertizës së kandidatit si pedagog.

37. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është vlerësues të dokumenteve profesionale është **‘Origjinaliteti dhe/ose impakti’**. Nisur nga profili profesional i kandidatit Indrit SHTUPI, përmbajtja e dokumentave të analizuar dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë që kanë të bëjnë kryesisht me punën e kandidatit pranë I.N.U.K pa përjashtuar këtu fushën e ekspertizës së kandidatit si pedagog. Për rrjedhojë krahas disa elementëve të origjinalitetit në përmbushjen e detyrës për aq sa e lejon natyra e funksionit të ushtruar, vlerësohet dhe nëse kandidati ka sjellë argumenta në dobi të punës në praktikën gjyqësore si dhe mirëfunksionimin e administratës publike.

38. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin **“Origjinaliteti dhe impakti”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

39. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me **“Aftësitë analitike”**, Komiteti tregon se në të vërtetë duke u përqëndruar në llojit “Diskutime përfundimtare të palës paditëse në çështjen civile I.Shtupi kundër I.N.U.K”, “Kërkesë për revokim të aktit administrativ drejtuar ILD”, “kërkesë bërë në emër të administratorit të shoqërisë Ad-Star”, “rregullim i ndërgjyqësisë”, “Kërkesë padi”, etj;

Dokumentacioni i administruar në tërësinë e tij, dëshmon zotërimin e aftësisë profesionale të kandidatit për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

40. Për rrjedhojë , pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin “**Aftësitë analitike**”, Komiteti vlerëson kandidatin me **4 (dy) pikë**.

41. Në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati.

42. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pike**.

43. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizoni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të mjaftueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.

44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizoni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

45. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret , nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të parashtrimeve në nivelin mjaftueshëm.

46. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

47. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **12 (dybëdhjetë) pikë**. (përfaqëson shumatoren e pikëve të anëtarëve plotëpjestuar me numrin e anëtarëve)

C.MERITA PROFESIONALE-KUALIFIM SHITESË PROFESIONAL

48. Rezultatet profesionale ne lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti per te vleresuar vecanerisht rendesine dhe dobine e profilizimit dhe specializimit te arritur në përvojat e vecanta profesionale te kandidatit te cilat tregojne vlere te spikatura profesionale ne sherbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit te Inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Larte te Drejtesise, si edhe te ushtrimit te kompetencave te ketij Institucioni, perfshire ketu vleresimin e njohurive te posacme profesionale ne lidhje me ushtrimin e kompetencave te kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera qe percaktohen nga ligji.

49. Prandaj, ne zbatim te ligjit, ne varesi edhe te profileve dhe karrierave profesionale te secilit kandidat, nga totali prej 10 pikesh per kete kategori vleresimi, Komiteti, vlereson deri ne 7 pike

ekspertizen ne fushat e se drejtes dhe posacërisht në cështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyre kontrolli, inspektimi dhe hetimi disiplinor si edhe kompetencave te tjera qe percaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlereson deri ne 3 pike angazhimet profesionale shtese te kandidateve. Ne arsyetimin dhe perfundimet e tij Keshilli mban parasysh rregullat e hollesishme te percaktuara Urdhërin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet ne percaktimin e pikeve perkatëse te merituar sipas Metodologjise per vleresimin dhe caktimin e pikeve per renditjen e kandidateve .

50. Në rastin e kandidatit, krahas jeteshkrimit, intervistes, motivimit per kandidim si edhe pranisë së vëzhguesit, Komiteti shqyrtoi dokumentet profesionale .

Angazhime profesionale shtesë:

51. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit INDRIT SHTUPI, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, të cilat janë përmendur më sipër në këtë vendim.

52. Për këtë arsye Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “**Angazhimeve profesionale shtesë**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre pikë)**.

Dokumentat që vërtetojnë rezultatet e procesit të vlerësimit profesional që kanë të bëjnë me Rolin dhe Funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

53. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se kandidati vlerësohet nga Komiteti me **0 (zero) pikë**.

MERITA MORALE

54. Si kriter vleresimi eshte percaktuar që kandidatet të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht percaktohen si kriteret vleresimi edhe "**Repulacioni qe gezon kundidati ne shoqeri dhe midis kolegeve**" dhe “cilësi morale të tilla si: Ndërshmëria, përpikmëria, drejtësia në marjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe "angazhimi i provuar ne ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.

55. Prandaj, ne zbatim te ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikesh per te tre komponentet vleresues, Komiteti vlereson deri ne 15 pike integritetin etik dhe moral, deri ne 8 pike reputacionin qe gezon kandidati ne shoqeri dhe midis kolegëve dhe deri ne 2 pike angazhimin e provuar ne ndjekje te kazuave të shoqërisë civile.

56. Ne rastin e kandidatit, krahas jeteshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve ne interviste, motivimit per kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjate procesit te verifikimit dhe vleresimit te kandidatures.

57. Komiteti shqyrtoi te dhenat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. si edhe cdo te dhene a dokument tjetër të aksesueshem publikisht nepermjet te cilave mund te nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vleresimit te meritave morale te ketij kandidati.

INTEGRITETI ETIK E MORAL

58. Per sa i perket kriterit te pare vleresues, integritetit etik e moral, nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera zyrtare apo te aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati ne veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon perkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe ne ushtrimin e profesionit, si edhe vemendje, ndjeshmeri dhe respekt ne komunikim e bisede, duke parashtruar argumentat e tij me kompetence, dinjitet, duke degjuar dhe pergjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje perkundrejt qendrimeve dhe pyetjet te cilat i drejtohen nga bashkebiseduesit.

59. Nga te dhenat e mundshme ne dispozicion, Komitetit nuk i rezulton qe kandidati te ushtroje apo te kete ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar pale te caktuara apo duke kerkuar perfitime per veten apo per te tjeret. Nuk rezultojne te dhena qe ky kandidat te mos kete respektuar detyrimin profesional te nderit dhe te dinjitetit, të ndertimit te marredhenieve profesionale dhe miresjelljes ne raport me koleget, profesionistet e fushes, palet e perfshira ne ceshtje pune etj .. Por duhet thënë se ky kriter është kriter diskrecional në varësi të "bindjes së brendshme të komitetit".

60. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues te "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlereson kandidatin me **2 (dy) Pike**.

Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve

61. Për sa i përket kriterit te dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve, nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim, Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera të paraqitura nga kandidati, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe perkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

62. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarine e tij permbush në nivelin “maftueshëm” për sa i përket pergjegjesive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmerine e publikut per gezimin e cilesive profesionale e morale per ushtrimin e detyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise, ne lidhje me kriterin vleresues “**të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **6.3 (gjashtë pik tre) pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

63. Per sa i perket kriterit te trete vleresues “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera zyrtare apo te aksesueshme publikisht, Keshillit i rezulton se, pergjithesisht, kandidati nuk ka qene e angazhuar në veprimtari te tjera të pershtatshme jashte atyre te lidhura me ushtrimin e detyres ose te profesionit per ndjekje te kauzave te shoqerise civile.

64. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues te “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlereson kandidaten me **O (zero) Pike**.

MERITAT ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE

65. Ky komponent zberthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilesine e platformes dhe te vizionit qe paraqesin;
- b) aftesite e provuara per te marre vendime dhe pergjegjesi bazuar ne pervojat e meparshme profesionale dhe shoqerore;
- c) aftesite e komunikimit;
- d) aftesite e te punuarit ne grup dhe ne ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- dh) aftesite e perfaqesimit publik.

66. Ne baze dhe per zbatim te ligjit, lidhur me keto kriteret vleresimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*” ku percaktohen rregullime me te hollesishme si edhe shperndarja e pikeve te vleresimit sipas peshe specifike te ketyre kriterëve.

67. Prandaj, ne zbatim te ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikesh per të pese komponentet vleresues te sipercituar, Komiteti vlereson deri ne 8 pike cilësinë e platformës dhe vizionin qe paraqesin kandidatet, deri ne IO pike aftësitë e provuara për të marë vendime dhe pergjegjesi bazuar ne pervojat e meparshme profesionale dhe

shoqerore, deri ne 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësite e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pike per aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.

Ne arsyetimin dhe perfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollesishme te percaktuara me Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, *“Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet ne percaktimin e pikeve perkatese te merituar sipas Metodologjise per vleresimin dhe caktimin e pikeve per renditjen e kandidateve per Inspektor .*

68. Komiteti shqyrtoi permbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsyt apo motivet e kandidimit dhe vizionit te kandidatit lidhur me qasjen dhe qendrimet e tij mbi rendesine dhe aspektet thelbesore te ushtrimit te detyres se Inspektorit, mbi sfidat kryesore me te cilat duhet te perballtet Inspektori i Larte i Drejtesise në ushtrimin e pergjegjesve dhe kompetencave qe i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit per ceshtjet qe duhet te trajtohen me perparesi e ne perspektive per mireorganizimin dhe mirefunksionimin e ketij institucioni te ri dhe shume te rendesishem kushtetues, per ushtrimin efektiv dhe me nivel te larte profesional e besueshmerie te kompetencave te tij ne funksion te ndertimit te nje sistemi drejtesie të bazuar ne integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmerite e jashtezakonshme të publikut pas miratimit dhe venies ne zbatim te reformes ne drejtesi. Gjithashtu, ne vleresimin e ketij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhena nga ky kandidat gjate intervistes dhe ne pergjigje te pyetjeve qe iu drejtuan nga anetaret e Komitetit.

69. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjate intervistes, Komiteti veren se kandidati paraqiti nje nivel mesatar te njohjes dhe pervesje profesionale ne lidhje me rolin dhe pritshmerite per ushtrimin e funksionit te Inspektorit jomagjistrat pranë zyrës së Inspektorit te Larte te Drejtesise, per sa i perket sfidave me te cilat do te perballtet fillimisht krijimi i ketij institucioni, objektivat per ceshtjet e organizimit dhe funksionimit cilesor dhe efektiv të institucionit te ri kushtetues te Inspektorit te Larte te Drejtesise duke u vene theksin te pavaresia e tij, respektimi i procesit te rregullt ligjor, zhvillimi i marredhenieve me publikun.

70. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues “Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur” nga kandidatet, Komiteti e vlereson kandidatin e **2 (dy pike) Pike.**

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar ne përvorjat e mëparshme profesionale shoqërore

71. Lidhur me aftësite e provuara per te marre vendime dhe pergjegjesi, Komiteti mbeshetet pikeseperari ne te dhenat qe lidhen me pervesja konkrete nga karriera e kandidateve ne funksione dhe pozicione te cilat kerkojne dhe tregojne marrjen persiper te pergjegjesive dhe ushtrimin e vendimmarrjes ne permbushjen e kompetencave dhe të detyrave te ngarkuara, vecanerisht per

aspektet e drejtimit dhe te administrimit te puneve. Ne kete drejtim, Komiteti shqyrton dhe vlereson posacerisht aftesite e provuara ose premtuese per te marre nisma, per te kerkuar zgjidhje, per te marre pergjegjesite si edhe per te marre ne vendimet e duhura e ne kohen e duhur sipas percaktimeve te ligjit dhe ne pergjigje te ndjeshmerise se publikut.

72. Ne rastin e kandidatit, krahas jeteshkrimit, parashtrimeve dhe bisedes ne interviste, permbajtjes se platformes dhe motivimit per kandidim, Komiteti shqyrtoi te dhenat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare te administruara ne dosjen e kandidates. per te evidentuar te dhena ne lidhje me aftesite e provuara apo premtuese te ketij kandidati per te marre vendime dhe pergjegjesi edhe ne ushrimin e funksionit te Inspektorit te Larte te Drejtesise.

73. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues "aftesite e provuara per le marre vendime dhe pergjegjesi bazuar ne pervojet e meparshme profesionale dhe shoqërore", Keshilli e vlereson kandidaten kandidatin me **3 (tre) Pike**.

Aftesite e komunikimit dhe aftësite e përfaqesimit publik

74. Aftesite e komunikimit, ne te gjitha format, vecanerisht me nepunesit dhe punonjesit e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise, me organet e tjera te qeverisjes se sistemit te drejtesise dhe perfaqesuesit e tyre, me gjyqtaret dhe prokuroret, sikurse edhe ne komunikimin dhe perfaqesimin publik e me te tretet, te shprehurit ne menyre te qarte, lehtesisht te kuptueshme, te matur, me respekt dhe ne menyre jodiskriminuese, luajne një rol te rendesishem ne kryerjen e funksionit kushtetues te Inspektorit te Larte te Drejtesise.

75. Nga shqyrtimi i jeteshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim te platformes, sjellja, menyra e komunikimit dhe argumentimit gjate bisedes ne interviste, si edhe nga permbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit te dokumenteve profesionale te administruara ne dosjen e kandidatit, Komiteti veren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme per te komunikuar me maturi, per te degjuar me respekt dhe per tu pergjigjur me profesionalizem, qartesi e thjeshtesi, me stil dhe gjuhe te pasur ne lidhje problematikat qe vlereson te trajtohen, ashtu edhe per ceshtje dhe problematika qe ngrihen nga te tjeret.

76. Gjithashtu, referuar prezantimit te bere gjate intervistes, rezulton se kjo kandidate zoteron edhe aftesi te mira per perfaqesimin publik, ,prezanton thjeshtesi, aftesi per te shprehur bindjet e saj me vetebesim. Kandidai transmeton besueshmeri gjate komunikimit dhe aftesi per tu pergjigjur me etike.

77. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues te " Aftesite e komunikimit dhe aftësite e përfaqesimit publik", Komiteti e vlereson kandidatin **me 2 (dy) Pike**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore

78. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nepunësit dhe punonjësit e Zyres së Tij dhe për atë që kërkohej dhe nevojitet me funksionare dhe përfaqësues të institucioneve të tjera. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevojja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për të qenë i përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

79. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, nga sjellja në tërësi e kandidatit, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti ka vlerësuar aftësitë e kandidatit për të punuar në grup, përfshirë ato për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore", Këshilli vlerëson të caktojë kandidatës **0.6 (zero pik gjashtë) pikë**.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

81. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit Jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezultoi se kandidati INDRIT SHTUPI vlerësohet në total **me 41 (dyzet e një) pike**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyres së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë:


VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidates INDRIT SHTUPI, **41 (dyzet e një)pike**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant **Inspektor Jomagjistrat**, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

2. Ky vendim i njoftohet kandidatit INDRIT SHTUPI.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

ANËTARE
Mirela KAPO



ANËTARE
Marsela PEPI



KRYETARI
Artur Metani

